

VENDIM
Nr. 449, datë 29.6.2022

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12 e 17, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të sistemit të institucioneve të tjera qeveritare (Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm), për vitin 2022, reduktohet me 8 (tetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të institucioneve të tjera qeveritare në 1 355 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2022, shtohet me 8 (tetë) veta për aparatën e Ministrisë së Brendshme, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të Ministrisë së Brendshme në 15 119 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) punonjës.

3. Në programin 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, për Ministrinë e Brendshme, shtohet fondi prej 11 936 791 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh, i ndarë në zërin “Shpenzime korrente”, 11 436 791 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë dhe në zërin “Shpenzime për investime”, 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për vitin 2022, për aparatën e Ministrisë së Brendshme.

4. Në programin 01150 “Shërbime të tjera”, për institucione të tjera qeveritare (Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm), reduktohet fondi prej 11 936 791 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh, i ndarë në zërin “Shpenzime korrente”, 11 436 791 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë, dhe në zërin “Shpenzime për investime”, 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për vitin 2022, për Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

5. Numri i përgjithshëm i punonjësve organikë buxhetorë nuk ndryshon.

6. Ngarkohen Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj